
VËREJTJE TË PËRGJITHSHME PËR LEKSIKUN E GJELLËTARISË DHE TË KUZHINËS NË GJUHËN SHQIPE SIPAS LËNDËS SË *FJALORIT TË GJUHËS SË SOTME SHQIPE (1980)* COMMON OBSERVATION OF FOOD AND CULINARY LIXIC IN ALBANIAN LANGUAGE BASED ON *DICTIONARY OF MODERN ALBANIAN LANGUAGE (1980)*

MIGENA RIZA
Tiranë, SHQIPËRI

AKTET VI, 5: 533 - 536, 2013

PERMBLEDHJE

Paraqitet një analizë të pasurisë të kësaj fushe semantike sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (1980). Së pari kemi evidentuar të gjitha emërtimet që janë shënuar me shkurtimin gjell. (= gjellëtari), duke vënë në dukje vendin që zënë këto emërtime në tërësinë e "Fjalorit". Në kumtesë bëhet një analizë e këtij leksiku nga disa pikëpamje: (a) nga përhapja e fjalës: fjalë të përgjithshme – fjalë krahinore; (b) nga përdorimi i fjalës: fjalë të përdorimit aktiv – arkaizma; (c) nga pikëpamja e burimit: fjalë me burim nga brumi i gjuhës shqipe – fjalë të huzuara në kohë të ndryshme nga gjuhë të ndryshme, veçanërisht nga turqishtja; (ç) nga pikëpamja e formimit dhe e motivimit: fjalë të parme, të prejardhura, të përbëra. Kumtesa synon të hapë një diskutim për mënyrën si janë pasqyruar këto emërtime që përmbajnë shënime të caktuara sipas vlerës stilistike dhe të ndihmojë me ide të reja për një pasqyrim më të plotë të emërtimeve të kësaj fushe në një fjalor të ardhshëm të gjuhës shqipe.

Fjalët çelës: gjellëtari, vlerë stilistike, semantikë.

SUMMARY

The vocabulary present a richness analyse of this semantic field based on Dictionary of Modern Albanian Language (1980). First of all we have taken all the words that are marked will the abbreviation to emphasize the place that occupate in the vocabulary. In the commentary is made on analyse of this lexic in different views: (a) the spread of word common - word regional word ; (b) the use of word: words with active - use archaize; (c) the origin of the word words: that comes directly from the albanian language - borrowed words in different times by different languages, particularly from turkish; (d) by terms of formation and motivation: front words, derived words, compound words. The commentary ains to open a discussion for the manner that this words are refrected, the words that contain certain notes according to the stylistic values and to help with new ideas for a full representation of this words in future vocabulary of albanian language.

Key words: food, semantic, stylistic values.

Hyrje

Në fushën e leksikut çështjet që mund të trajtohen janë të shumta, por me interes do të ishte edhe trajtimi i emërtimeve të sferës së ushqimit, duke përfshirë lëndët ushqimore, gatesat, pijet, si dhe emërimet e orendive të kuzhinës.

Punimi i pranishëm është mbështetur kryesisht mbi *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (FGjSSh) të

botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1980), që mbetet ende fjalori më i plotë deri sot i gjuhës shqipe, sidomos nga pikëpamja e zbërthimit dhe e ilustrimit të kuptimeve dhe të fjalëve, si dhe e pajisjes me shënime stilistike e terminologjike. Nga FGjSSh kemi vjelë fillimisht shterueshëm të gjitha emërtimet që janë shënuar me shkurtimin *gjell.* (= gjellëtari). Por në përfundim të kësaj pune vumë re se në FGjSSh ky

shënim nuk është vënë kudo me të njëjtin kriter, p.sh. janë shënuar me shkurtimin *gjell*. fjalët *qullanik* e *qullash*, por jo vetë fjala *qull*, prej së cilës janë formuar e motivohen ato; po kështu te fjala *çorbë* është vënë shënimi *gjell.*, ndërsa te fjala *supë* mungon; ose është vënë te fjala *reçel*, por mungon te fjala *gliko*, e cila shpjegohet si një lloj reçeli; mungon shënimi *gjell*. te fjalë si: *pelte*, *pure*, *fërgesë*, *përshesh* etj. Shembuj të tillë ka me dhjetëra, prandaj na u desh të vjelim edhe një herë me kujdes FGjSSH, në mënyrë që korpusi i emërtimeve të kësaj sferë të ishte sa më i plotë e i saktë.

Në përfundim u ndërtua një korpus emërtimeve njëfjalësha me (107) njësi. Në një pjesë prej tyre kuptimi i sferës ushqimore dhe kuzhinës është i vetmi (fjalë të njëkuptimshme), si p.sh. *ajkëtor*, *amaretë*, *arançatë*, *bacarak*, *byrek*, *djathë*, *dredhanik*, *dhallë*, *dhallëtor*, *fërgesë*, *fërnet*, *gliko*, *gjalpë*, *gjizë*, *japarak*, *konjak*; te një pjesë tjetër është kuptimi i parë, p.sh. *alkool*, *ashure*, *bukë*, *cikth*, *çapë*, *drudhe*, *hikërr*, *kulaç*, *mastikë*, *uthull*, *vaj*; te një pjesë tjetër është kuptim i dytë, i tretë. d.m.th. kuptim i prejardhur, p.sh. *brinjë*, *calik*, *lakuria*, *larash*, *llull/ë*, *mashkull*, *mbushje*, *nuskë*, *penik*, *plëndës*, *kripore*, *qeveri*, *rusica*.

Korpusi i fjalëve yë marra në shqyrtim

Fjalët e korpusit janë vështruar nga pikëpamja fjalëformuese, semantike dhe statistikore. Një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe përcaktimit të burimit të këtyre emërtimeve, të cilat në fushën e gjellëtarisë në gjuhët e Ballkanit kanë hyrë kryesisht nga turqishtja, si: *akçiash*, *arapash*, *ashure*, *hardall*, *hasude*, *imambajaldi*, *qebapi*, *qeshqek* etj., kjo si pasojë e ndikimit të qytetërimit oriental të bazuar në fenë islame. Por, siç është vënë në dukje, vetë turqishtja, një pjesë të mirë të emërtimeve të kësaj fushe i ka marrë nga persishtja, pasi persët kanë pasur një traditë qytetërimi më të pasur e më të lashtë në krahasim me turqit osmanë, që kanë qenë popull nomad derisa u ngulën në Azinë e Vogël.

Përveç orientalizmeve ajo që vihet re është dhe ndikimi i gjuhëve perëndimore, që shfaqet në huazime të tilla si: *beshamel*, *buding*, *majonez*, *omëletë*, *rosto*, *salcë*, *salsiçe* etj. Por siç do të

shpjegohet edhe më poshtë te analiza fjalëformuese, një pjesë jo e vogël e emërtimeve të kësaj fushe janë fjalë shqipe ose formime nga fjalë shqipe që shënojnë sende ushqimore si: (*ajkë-tor*, *brum-anik*, *bukë-vale* etj.); veprime që kryhen për përgatitjen e tyre si: (*mbush-je*, *trazore*) etj.

Kështu, në analizën fjalëformuese do të trajtojmë ato fjalë që janë formuar brenda gjuhës shqipe, me mënyrat fjalëformuese të gjuhës sonë, ndërsa fjalët me prejardhje të huaj nuk analizohen nga pikëpamja e fjalëformimit, sepse ato janë marrë të gatshme nga gjuha e huaj ku janë formuar.

Leksiku i gjellëtarisë nga pikëpamja e fjalëformimit

Emërtimet që i përkasin sferës së leksikut të gjellëtarisë, me ose pa shkurtimin *gjell*. në FGjSSH hyjnë në kategorinë leksiko-gramatikore të emrit. Shumica e tyre janë fjalë të parme, si *bukë*, *bulmet*, *djathë*, *gjizë*, *uthull*, *vaj* etj., ose huazime nga gjuhë të tjera, si *byrek*, *çomlek*, *çorbë*, *pilaf* etj. (orientalizma); *biftek*, *majonezë*, *supë*, *salcë* etj. (huazime moderne), që nuk i nënshtrohen analizës fjalëformuese brenda shqipes dhe merren gjithashtu si fjalë të parme. Një numër emërtimeve të tjera që janë formuar brenda gjuhës shqipe klasifikohen në:

Fjalë të prejardhura

Pjesa më e madhe e emërtimeve të pa huazuara janë formime me prapashtesa. Prapashtesa zakonisht bashkohet me një temë emërore që shënon lëndën prej së cilës përgatitet gatesa. Bie në sy se prapashtesa më e përdorshme për formimin e emërtimeve të gjellëtarisë është *-nik*. Kjo prapashtesë ka përhapje më të dendur në toskërishten verilindore, ku përfshihet edhe zona Pogradec–Korçë–Kolonjë.

-nik. Prapashtesa *-nik* zakonisht bashkohet me një temë emërore që shënon lëndën kryesore prej së cilës përgatitet gatesa, ose një lëndë përbërëse të rëndësishme, p. sh.: *brum-anik*, *djath-anik*, *gjalp-anik*, *gjet-anik*, *gjiza-nik*, *kungull-nik*; këtu mund të përfshihet edhe fjala *lesh-nik* "lloj ëmbëlsire me qumësht delesh e me

miell”, sepse tema “lesh” në këtë rast ka kuptimin “qumësht i bagëtive të leshta” (dele).

Me prapashtesën *-nik* janë formuar edhe emërtimet:

copkanik “bukë misri e hollë, e gatuar me ujë të valë” (ndoshta sepse duke qenë e hollë, thyhet lehtë copa-copa);

dredhanik “lloj ëmbëlsire me petë të mbështjella rrumbullak e të vendosura rrotull në tepsi, së cilës, pasi të piqet, i hidhet përsipër sheqer a sherbet; radhanik” (motivohet kuptimisht nga veprimi i dredhjes së petëve);

mesnik “byrek me copa mishi e me petë të pjekura në mes”;

radhanik “dredhanik” (motivohet nga vendosja radhë-radhë në tepsi);

rrethanik “ëmbëlsire e gatuar me petë të dredhura si kukurec e me arra brenda, që piqet në furrë e zbutet me sherbet;

dredhanik” (motivohet nga forma rrethore).

Prapashtesa të tjera janë:

-arak, te *bacarak* “lakror që bëhet me miell misri dhe me presh, me hithra ose me lakra të tjera”. Sipas Eqrem Çabejt është një variante fonetike e fjalës *përcëllak* (SEFSh II: 122);

-ash, te: *dërrmash* “djathë i butë, i thërrmuar e i përzier me bukë a me miell misri dhe me gjalpë, që piqet në furrë a zihet në kusi të mbyllur e hahet i ngrohtë” (motivohet nga folja “dërrmoj”); *qullash* “lakror me petë të trasha, me presh ose me lakra dhe me oriz e vezë” (motivohet nga “qull”);

-çkë/-kë, te *byreçkë* (prapashtesë zvogëlimi); te *rrufkë* “petulla të bëra me miell, me qumësht e me vezë dhe të skuqura me shumë vaj, që përvëlohen në sherbet” (nuk është i qartë motivimi i emërtimit);

-ec, te *bukafec* “lakrori i bërë me brumë të ardhur lakrori i mbrumë” (motivohet nga *bukë*);

-ere, te *qoftere* “lloj qofteje e madhe, e gjerë dhe pak si e hollë”.

-esë, te *fërgesë* (nga folja *fërgoj*), *gatesë* (nga folja *gatuaj*), *mëlmesë* (nga folja *mëlmej*);

-ëz, te *kordhëz* “zorrë bagëtish të imëta, të pleksura në disa radhë dhe të ziera a të pjekura në tavë” (motivohet me sa duket nga emërtimi

kordë/kordhë me kuptimin “diçka që gërshetohet në një formë të zgjatur”).

-je, te *mbushje* “lëndë e parapërgatitur me të cilën mbushen specat, domate, byreku etj.” (motivohet nga folja *mbush*);

-or, te: *ajkëtor* “gatesë me miell, me ajkë qumështi a me gjalpë, e pjekur në tepsi” (motivohet nga *ajkë*); *lakror* (motivohet nga *lakra*);

-ore, te *trazore*, “lloj buke e valë, që bëhet me miell misri, me gjalpë e me djathë dhe që piqet në furrë” (motivohet nga folja *trazoj*);

-ri, te *bonjëri* “gjë e mirë në të ngrënë, gatesë shumë e shijshme; ëmbëlsirë” (ndoshta motivohet nga emri *bonjë*: “1. Bletë femër, që mbledh mjaltin lule më lule; 2. *përd. mb. fig.* Që e do punën, që punon shumë e mirë, e pa përtuar, punëtore e madhe (për gruan)”).

Konversion

Me këtë mënyrë janë formuar dy emërtime:

lakuriq-i “gatesë me miell, me gjalpë, me vezë etj., që shtrohet në tepsi pa u mbuluar me petë dhe piqet në furrë” (qohet kështu meqë nuk mbulohet me petë);

e matur “ëmbëlsirë e përgatitur me miell, sheqer, gjalpë ose vaj dhe me ujë në të njëjtën masë, që, pasi zihet, shtrohet në tepsi dhe piqet në furrë a në saç” (motivohet nga folja *mas - matur*).

Kompozita

Fjalët kompozita nga kjo fushë janë të rralla: *bukëveale*, *byreksheqer*, *këmbëkuqe*, *laropitë*. Te *bukëveale* e *byreksheqer* kemi bashkimin e një teme emërore (*bukë*, *byrek*) me një tjetër temë emërore (*vale*, *sheqer*); edhe te *laropitë* “njëlloj lakrori që bëhet me miell misri të përzier me barishte të ndryshme (zakonisht me spinaq) e me djathë të grirë” kemi dy tema emërore *larë* dhe *pitë* (nga djathi i grirë ky lloj lakrori duket lara-lara); te *këmbëkuqe* “mëmëligë e gatuar me miell misri dhe me sheqer; bukë misri e thërrmuar dhe e fërguar me gjalpë, që hahet me sheqer, me pekmez ose me mjaltë” kemi bashkimin e një teme emërore me një temë mbiemërore (i paqartë motivimi).

Siç shihet, emërtimet e fushës së gjellëtarisë të përfshira në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*

(1980) japin pak material për analiza fjalëformuese. Por, kur të kemi një korpus më të madh e më të plotë të emërtimeve të kësaj fushe, që përdoren nëpër të folme të ndryshme në mbarë truallin e shqipes, atëherë mund të trajtohen më mirë edhe veçoritë e fjalëformimit të këtyre emërtimeve.

Klasifikimi sipas shkallës së përdorimit

Një klasifikim tjetër është edhe ndarja e këtyre emërtimeve sipas shkallës së përdorimit në jetën e përditshme, ku kam dalluar dy grupe kryesore:

a) emërtime me përdorim deri diku të gjerë (61 fjalë)

b) emërtime me përdorim deri diku të kufizuar (44 fjalë).

Për dallimin e këtyre dy grupeve jam mbështetur kryesisht te përshtypja ime, pasi në fjalor tek asnjë prej tyre nuk ka shënime shoqëruese, si p.sh. *vjet.* (fjalë e vjetruar), *hist.* (historizëm) dhe vetëm në dy fjalë: *copkanik* dhe *zerva* është vënë shënimi *krahin.* (= fjalë me përdorim krahinor). Megjithëse nuk e kanë shënimin *krahin.*, shumë prej fjalëve të grupit të dytë “emërtime me përdorim deri diku të kufizuar” mendoj se duhej të ishin cilësuar kështu, p.sh. *bacarak*, *bonjëri*, *bukafec*, *këmbëkuqe*, *laropitë* etj.

Përfundim

Klasifikimi që kam bërë, nuk mund të quhet krejt objektiv, pasi ka ndikuar, nga njëra anë, moshë ime e re dhe përvoja e kufizuar jetësore. Tek grupi i parë kam dalluar dy nëngrupe: (a) emërtimet popullore tradicionale; dhe (b) emërtime të reja, që janë huazime nga gjuhët perëndimore dhe kanë hyrë në gjuhën shqipe kryesisht gjatë shekullit të kaluar (12 fjalë).

Emërtimet popullore tradicionale mund të jenë fjalë shqipe (zakonisht të prejardhura), si *dja-thanik*, *lakror*, *mbushje* etj., ose orientizma, si *çervish*, *çomlek*, *paçe* etj. Për një klasifikim më

objektiv të këtyre emërtimeve nga pikëpamja e përdorimit, duhen bërë anketa me kriterë të studiuar me kujdes. Këtë e kam menduar ta realizoj në vijim të studimit të mëtejshëm të kësaj teme.

Bibliografia

ÇABEJ, Eqrem (), *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. vëll. I, II, III, IV, VI, VII. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

ÇABEJ, E. (1975), Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes: *Studime Filologjike*, Tiranë, 1.

ÇABEJ, E. (1976), Histori fjalësh të sllavishtes e të shqipes: *Studime Filologjike*, Tiranë, 1.

GJINARI, Jorgji – SHKURTAJ, Shkurtaj (2004), *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë.

ISLAMAJ, Shefkije (1986), Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe, *Studime Filologjike*, Tiranë, 4.

KOSTALLARI, A., THOMAI, J., LLOSHI, Xh.etj (red. 1980), *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.

KOSTALLARI, Androkli (1978), Rreth depërtimit të turqizimeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII: *Gjurmime Albanologjike – Seria e Shkencave Filologjike*, IAP, Prishinë.

SAMARA, Miço (2000), *Hulumtime në leksikografi*, Tiranë.

THOMAI, J., SAMARA, M. etj. (red. 2006), *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë.

THOMAI, Jani (1964), Mbi mënyrën e pasqyrimin të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe: *Studime Filologjike*, Tiranë, 4.

THOMAI, Jani (1981), *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë.

THOMAI, Jani (2005), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.

XHUVANI, Aleksandër – ÇABEJ, Eqrem (1962), *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë.

XHUVANI, Aleksandër (1956), *Studime gjuhësore*, Tiranë.